



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 26.02.2026, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Mbyllet rasti DPKI-ERIVQJ-0366/25, për zyrtarin e lartë publik z. Muharem Faiku, Dekan i Fakultetit Juridik të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

## A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Muharem Faiku, Dekan i Fakultetit Juridik të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren (në vijim: UUHP), është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI) dhe Rregulloren nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Ky rast (DPKI-ERIVQJ-0366/25) ka filluar të trajtohet pas informatave të pranuar nga jashtë - raportuesi i rastit, me të cilën është ngritur dyshimi për konflikt të interesit për z. Muharem Faiku, pasi që siç është pretenduar, në cilësi të Dekanit të Fakultetit Juridik të UUHP-së, ka marrë vendim për anulimin e notës së studentes së vitit të dytë S. V. dhe njëkohësisht ka qenë pjesë e komisionit që e pyet studenten.

Tutje raportuesi i rastit ka theksuar se, citojmë pjesë relevante nga raportimi: “[...] studentes në fjalë [...] i është larguar nota nga sistemi me urdhër të Dekanit të Fakultetit Juridik. Ky vendim konsiderohet plotësisht i jashtëligjshëm, ashtu edhe procedura e ndjekur. [...] Ditën që është marrë vendimi, po atë ditë është larguar nota e studentes nga sistemi. Në vendim, Dekani e cakton vetveten si pjesë e komisionit për ta pyetur studenten [...]. Si pasojë e kësaj procedure, për shkak se vetë Dekani ishte pjesë e komisionit, studentja është rrëzuar në provim. [...] studentja është dëmtuar nga një veprim i paligjshëm administrativ, konkretisht: nota e saj është larguar nga sistemi, pa respektuar afatet ligjore të ankesës, dhe më pas studentja është rivlerësuar nga një komision ku bën pjesë vetë Dekani, i cili paraprakisht ka marrë vendimin për anulimin e notës [...].”

Andaj, raportuesi i rastit ka parashtruar disa pyetje lidhur këtë situatë: *“A përbën konflikt interesi fakti që i njëjti person (dekani) merr vendim për anulimin e notës, e vendos veten anëtar të komisionit për rivlerësimin e të njëjtës studente dhe njëkohësisht është pjesë e komisionit që e pyet studenten?; A është e lejuar, nga aspekti i parimeve të paanshmërisë dhe të administrimit të drejtë, që i njëjti autoritet të jetë njëkohësisht vendimmarrës dhe vlerësues?; A përputhet kjo praktikë me standardet e integritetit akademik dhe legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit?; A përbën kjo konflikt interesi?”*

Më pas, raportuesi ka dërguar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) informata dhe dokumentacion shtesë në lidhje me rastin, ashtu që ka njoftuar se: *“[...] më datë 22.01.2026, Dekani i Fakultetit Juridik ka vepruar sërish në të njëjtën çështje, duke marrë të njëjtin vendim dhe duke i pyetur/rivlerësuar studentët, ndonëse është pikërisht ai person që më herët ka marrë vendimin për anulimin e notës. Ky veprim, [...] e përforcon edhe më tej dyshimin për konflikt interesi dhe mungesë të paanshmërisë, pasi i njëjti autoritet që ka marrë vendimin fillestar po ushtron edhe kompetencën e rivlerësimit, duke ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e procesit. Një situatë e tillë cenon parimet themelore të objektivitetit, barazisë dhe drejtësisë procedurale [...]”*.

Raportimit të rastit dhe plotësimin të tij i janë bashkangjitur Vendimi nr. i ref. 01-125, i datës 07.10.2025, Vendimi nr. ref. 01-36, i datës 21.01.2026, dhe Përgjigja e Agjencisë DPKI-1996/25, e datës 03.10.2025.

Nga informatat që përmban raportimi i rastit dhe dokumentacioni i bashkangjitur, rezulton se përveç pretendimeve për konflikt të interesit, raportuesi i rastit ka ngritur edhe pretendime tjera lidhur me (pa)rregullsinë e procesit të anulimit të notës dhe procesit të vlerësimit të studentes, (pa)ligjshmërinë e vendimeve të dekanit në këtë proces, si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me dyshimet për veprime hakmarrëse nga dekani, të cilat pretendime nuk lidhen me dyshimet për konflikt të interesit. Por, Agjencia konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ duke shqyrtuar raportimin, vetëm në kontekst të dyshimeve për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së.

Kësisoj, Agjencia ka trajtuar dhe shqyrtuar këtë çështje vetëm sa i përket pretendimeve nëse paraqet situatë të konfliktit të interesit konform dispozitave të LPKI-së, vendimmarrja e z. Muharem Faiku me rastin e anulimit të notës, caktimit të komisionit dhe pjesëmarrja e tij si anëtar i komisionit për vlerësim të studentes.

Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-3196/25, ka kërkuar informata, sqarime dhe dokumentacion nga zyrtari i lartë z. Muharem Faiku, lidhur me procesin e vlerësimit të studentes S. V.. I njëjti, përmes shkresës zyrtare DPKI-133/26, ka dërguar në Agjenci deklarinë e tij me shkrim lidhur me procesin në fjalë, përfshirë informatat, sqarimet dhe dokumentacionin përkatës.

Zyrtari i lartë z. Muharem Faiku, përmes deklarinës me shkrim të dërguar në Agjenci, ka dhënë sqarimet e tij lidhur me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit, ashtu që i njëjti ka deklaruar se, citojmë pjesë relevante nga deklarimi i tij: *“[...] Vlerësimi i studentes së lartcekur është bërë sipas vendimit të datës: 07.10.2025, dhe rezultati ka qenë negativ. Provimi është zhvilluar me shkrim dhe është korrigjuar ndaras nga tre anëtarët e komisionit. Kandidates në fjalë i'u është ofruar dhe mundësia që provimi të mbahet edhe gojë, por është refuzuar nga ana*

*e kandidatës. Kundër vlerësimit të kandidatës nga ana e komisionit nuk është ushtruar ankesë. Rregullorja për Përcaktimin e Kriteve të Studimeve Themelore, është akti nënligjor në fuqi në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, ku rregullohen procedurat për vlerësimin e studentëve nga komisioni dhe nuk parasheh që Dekani i Fakultetit nuk mund të jetë anëtarë i Komisioni Vlerësues. Përveç kësaj, gjatë këtij procesi nuk ka pasur as një kërkesë prej palëve për përjashtim nga procedura të ndonjë anëtari të Komisionit për Vlerësim, dhe as një deklaram të konfliktit të interesit nga anëtarët e këtij komisioni në raport me palën apo çështjen."*

Me qëllim të sqarimit të rastit, Agjencia ka kërkuar informata dhe sqarime shtesë për këtë proces, të cilat informata dhe sqarime Agjencia i ka pranuar nga Sekretari i Fakultetit Juridik të UUHP-së.

Pas grumbullimit të informatave si më lartë, Agjencia pasi ka administruar si prova raportimet e raportuesit të rastit dhe dokumentacionin e bashkangjitur, deklaramet dhe sqarimet me shkrim nga z. Muharem Faiku dhe dokumentacionin e bashkangjitur, pastaj përgjigjen plotësuese të Sekretarit të Fakultetit Juridik të UUHP-së, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Më datë 07.10.2025, z. Muharem Faiku, në cilësi të Dekanit të Fakultetit Juridik të UUHP-së, ka nxjerrë Vendimin nr. ref. 01-125, me të cilin ka ndryshuar vendimin e datës 31.07.2025, ashtu që ka anuluar notën e studentes S. V. në lëndën "E drejta Sendore", afati i Qershorit 2024/2025, me konstatimin se ka konflikt interesi sepse është notuar nga motra e saj K. V. (pika 1. e vendimit).

Me të njëjtin vendim (pika 2.) është formuar Komisioni prej tre anëtarëve për vlerësimin e studentes për afatin e Shtatorit I, eventualisht Shtatorit II. Z. Muharem Faiku është caktuar anëtar i këtij komisioni.

Paraprakisht, sipas kërkesës së z. Muharem Faiku, Agjencia kishte dhënë një përgjigje zyrtare (DPKI-1996/25, e datës 03.10.2025) në lidhje me situatën e konflikt të interesit sa i përket notimit të studentes S. V. nga motra e saj K. V.

Referuar proceseve nr. prot. 01-178, 01-179 dhe 01-180, të datës 24.11.2025, rezulton se z. Muharem Faiku ka qenë pjesë e vlerësimit të studentes S. V., ndërkohë që e njëjta nuk ka kaluar provimin sipas vlerësimit të tre anëtarëve të komisionit. Agjencia nuk është lëshuar në aspektin e mënyrës së vlerësimit apo poentimit të studentes në fjalë nga anëtarët e komisionit, ngase një gjë e tillë është jashtë sferës së konfliktit të interesit.

Më pas, z. Muharem Faiku, në cilësi të Dekanit të Fakultetit Juridik të UUHP-së, ka nxjerrë Vendimin nr. ref. 01-36, i datës 21.01.2026, me të cilin është formuar Komisioni prej tre anëtarëve për vlerësimin e studentes S. V. për afatin e Janarit 2026, eventualisht afatin e Prillit 2026. Z. Muharem Faiku është caktuar anëtar i këtij komisioni.

Referuar përgjigjes zyrtare të Dekanit të Fakultetit Juridik të UUHP-së, rezulton se nuk ka pasur ankesa të parashtruara në procesin e vlerësimit të kandidatës S. V., dhe se me legjislacionin në fuqi të UUHP-së nuk ndalohet që dekani i njësisë akademike të jetë pjesë e komisionit për vlerësimin e studentëve.

Nga përgjigja e Sekretarit të Fakultetit Juridik të UUHP-së, në pyetjet e Agjencisë se: "Me legjislacionin në fuqi të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, konkretisht me rregulloren përkatëse në fuqi për të ardhurat dhe kompensimin e personelit akademik, a parashihet

*kompensim i anëtarëve për pjesëmarrjen e tyre në komisionin për vlerësimin e studentit në studimet themelore. A është kompensuar z. Muharem Faiku, si anëtar i Komisionit për vlerësimin e studentes S. V., sipas Vendimit nr. i ref. 01-125, i datës 07.10.2025 dhe Vendimit nr. ref. 01-36, i datës 21.01.2026. Nëse po, na dërgoni informatat e plota lidhur me kompensimin”, rezulton se, citojmë nga përgjigja: “Bazuar në Rregulloren për të ardhurat personale akademike, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren, nr. 01-554/A, datë 27.11.2023, si dhe në Rregulloren e re nr. prot. 01-661/A, datë 27.10.2025, nuk parashihet kompensim për anëtarët e komisionit të vlerësimit të studentëve në studimet themelore. Për rrjedhojë, komisioni i formuar sipas Vendimit nr. ref. 01-125, datë 07.10.2025, të cilit ju i referoheni, nuk është kompensuar.”*

Rrjedhimisht, z. Muharem Faiku nuk është kompensuar për punën e tij në komisionin për vlerësimin e studentes, komision ky i formuar me vendimet e lartcekura nga vet ai, përkatësisht nuk ka pasur përfitim nga pjesëmarrja e tij në këtë komision.

Andaj, në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 dhe nenit 17 lidhur me nenin 3, të LPKI-së.

Konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo për *personat e afërm* me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”,* ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *“Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”*

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *“interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”,* dhe nënparagrafi 1.12, me të cilin është e definuar nocioni i vendimmarrje si: *“çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”*

Në rastin konkret, në kuptim dhe zbatim të dispozitave si më lartë të LPKI-së, është fakt se z. Muharem Faiku ka marrë pjesë në vendimmarrje duke i nxjerrë dhe nënshkruar vendimin për anulimin e notës së studentes S. V. dhe vendimet për themelimin e komisionit për vlerësim të studentes në fjalë, por Agjencia konstatoi se situata e parashtruar nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit, përkatësisht nuk bie ndesh me dispozitat e LPKI.

Kjo për faktin se, nuk është gjetur se z. Muharem Faiku, të ketë pasur interes privat apo çfarëdo përfitimi nga vendimmarrjet e tij në këtë proces apo nga pjesëmarrja e tij në vlerësimin e studentes në fjalë, përkatësisht nga procesi i vlerësimit të saj sipas vendimeve nr. ref. 01-125, i datës 07.10.2025 dhe nr. ref. 01-36, i datës 21.01.2026, të cilat i ka nxjerrë dhe nënshkruar, e me të cilat e ka caktuar veten si anëtar të komisionit.

Rrjedhimisht, pjesëmarrja e zyrtarit në *vendimmarrje* dhe ekzistimi i *interesit privat* (çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste) të zyrtarit në atë *vendimmarrje*, janë kushte *kumulative* të cilat duhet të plotësohen në çdo rast për t'u konsideruar se ka konflikt të interesit në vendimmarrje, sipas dispozitave të nenit 6 dhe nenit 17, lidhur me nenin 3 të LPKI-së.

Në këtë rast, siç është konstatuar më lartë, z. Muharem Faiku me nxjerrjen dhe nënshkrimin e vendimeve për anulimin e notës së studentes S. V. dhe themelimin e komisionit për vlerësimin e saj, ka marrë pjesë në *vendimmarrje*, por këtu nuk është plotësuar kushti tjetër kumulativ, që është *interesi i privat*, përkatësisht përfitimi i çfarëdo përparësie për vete apo personat e afërm. Andaj, situata e parashtruar nuk bie ndesh me nenin 6, dhe 17, lidhur me nenin 3 të LPKI-së.

Me rastin e konstatimit dhe vendosjes si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, Agjencia ka pasur parasysh edhe pretendimet tjera të raportuesit të rastit, por të njëjtat pretendime nuk kanë ndikuar për të nxjerrë një konstatim dhe vendim ndryshe.

Agjencia ka pasur parasysh edhe pretendimet e raportuesit të rastit lidhur me dyshimet për jo objektivitet, paanshmëri dhe hakmarrje ndaj studentes S. V., për shkak të profesoreshës së lëndës (motrës së saj), nga z. Muharem Faiku në procesin e vlerësimit. Këto *mund* të jenë rrethana për përjashtimin e zyrtarit nga një çështje administrative konform dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative (në vijim: LPPA) apo legjislacionit për zyrtarët publik, por nuk mund të cilësohen si rrethana që *apriori* paraqesin konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së. Sepse, Agjencia përkitazi me konfliktin e interesit ka kompetencë vetëm për zbatimin e dispozitave të LPKI-së.

Kësisoj, Agjencia vlerëson se rrethanat e tilla është dashur fillimisht të deklarohen apo raportohen dhe më pas të trajtohen në kuadër të njësisë akademike – Fakultetit Juridik të UUHP-së, apo të njëjtat të trajtohen nga mekanizmat apo institucionet që kanë kompetencë për çështjen e referuar.

Me këtë rast duhet pasur në konsideratë zbatimin e dispozitave të LPPA-së për përjashtimin e zyrtarëve nga procedura administrative. Konkretisht, neni 29, paragrafi 1, nënparagrafët 1.6 dhe 1.10 të këtij ligji, me të cilin është përcaktuar se: “Një nëpunës nuk duhet të përfshihet në një procedurë administrative, nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë, në mënyrë të veçantë kur ndodhet në njërin nga këto situata: [...] 1.10. në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij”, dhe të vepohet sipas nenit 30 dhe 31 të LPPA-së.

Dekani dhe mekanizmat tjerë të përfshirë në procesin e vlerësimit të studentes S. V., duhet të kenë parasysh dispozitën e nenit 7, paragrafi 3, të LPKI-së, me të cilën është përcaktuar se: “Personi që ofron informata të bazuara për rastet e konfliktit të interesit gëzon mbrojtje në pajtim me ligjin”, dhe dispozitën e nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të LPKI-së, e cila parashih se: “1. Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime: [...] 1.12.

të ndërmarrë veprime me efekte ndëshkuese apo të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme të zyrtarëve apo subjekteve që ofrojnë informata për raste të konfliktit të interesit të zyrtarit, personave të lidhur me të ose personave të besuar për këtë shkak”, lidhur me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Dispozitat e LPKI-së nuk mëtojnë që të kufizojnë apo pengojnë ushtrimin e funksioneve publike, përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisive ligjore dhe kushtetuese në institucione publike, por përkundrazi, njëri ndër qëllimet e rëndësishme të këtij ligji është funksionimi i institucioneve publike përmes parandalimit të shfrytëzimit të funksionit publik për interesa private, përkatësisht parandalimit të situatave të konfliktit të interesit, duke mbrojtur kështu interesin publik, ruajtur kredibilitetin dhe imazhin e institucioneve publike.

Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- z. Muharem Faiku;
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

